

## **MEMORANDUM MIRËKUPTIMI**

### **NDËRMJET**

#### **MINISTRISË SE BRENDSHME TE REPUBLIKËS SE KOSOVËS MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHËM TE REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

#### **MBI**

#### **PATRULLIMIN E PËRBASHKËT PËRGJATË KUFIRIT SHETËTOR MIDIS REPUBLIKËS SE KOSOVËS EDHE REPUBLIKËS SE MAQEDONISË**

Ne baze te nenit te Marrëveshjes se dates 01.12.2009 ndërmjet Republikës se Kosovës dhe Republikës se Kosovës "Mbi bashkëpunimin policor ", Ministria e Brendshme e Republikës se Kosovës dhe Ministria e Punëve te Brendshme e Republikës se Maqedonisë (referuar ne këtë Protokoll si Palët Kontraktuese), duke respektuar marrëdhëniet miqësore midis dy vendeve, ne mënyre qe te saktësojnë dhe fuqizojnë bashkëpunimin midis Policive Kufitare te këtyre dy vendeve si dhe për te organizuar e për te kryer patrullime te përbashkëta, plane e masa te përbashkëta për një luftë me efektive kundër migracionit te paligjshëm, trafikimit te qenieve njerëzore dhe formave te tjera te krimit ndërkufitar, ranë dakord si me poshtë:

#### **Neni 1**

#### **Subjekti i Memorandumit**

Palet Kontraktuese, ne perputhje me Memorandumin, do te fuqizojne kooperimin midis policive Kufitare me qellim qe te pengojne venjen ne rrezik te rendit publik, te luftojne te gjitha format e krimit dhe te kene nje cilesi me te mire ne mbrojtjen e Kufirit Shtetor, duke percaktuar detajet dhe standartet unike ne ngritjen e patrullave te perbashketa ne territorin e te dy vendet

#### **Neni 2**

#### **Fusha e zbatimit të Memorandumit**

Protokolli rregullon detajet dhe standartet uniforme të patrullimit të përbashkët në territoret shtetërore të Republikës së Kosoves dhe Republikës së Maqedonise.

#### **Neni 3**

#### **Qellimi i ngritjes se patrullave te perbashketa**

Qellimi i ngritjes se patrullave te perbashketa eshte:

- Te forcohet siguria ne Kufirin Shteteror te perbashket
- Te pengohet migracioni ilegal
- Te pengohet krimi nderkufitar
- Te pengohen rreziqet e tjera ndaj sigurise publike
- Te rritet cilesia e vleresimit te sigurise
- Te forcohet kooperimi i Policive pergjate Kufirit Shteteror te perbashket.

#### **Neni 4**

##### **Detyrat e patrullave të përbashkëta**

Patrullat e përbashkëta:

- Kontrollonjë kufirin e përbashkët shtetëror në zonën ku ato janë përgjegjëse;
- Marrin masa për ndalimin e personave që kryejnë veprimtari kriminale nëpërmjet kufirit dhe bën bllokimin e mjeteve dhe të mallrave që hyjnë në mënyrë të paligjshme jashtë pikave të kalimit kufitar;
- Ndhmojnë në rastet e ngjarjeve të rënda ose forcës madhore që ndodhin në afërsi të kufirit;
- Shkëmbejnë eksperiencë dhe të dhëna për kushtet e sigurisë në kufirin e përbashkët shtetëror.

#### **Neni 5**

##### **Zona e veprimit**

1. Patrullat e përbashkëta veprojnë përgjatë kufirit shtetëror deri në largësinë 10 kilometra nga vija e kufirit në brendësi të territorit shtetëror të Palëve Kontraktuese.
2. Patrullimet e përbashkëta mund të kryhen jashtë zonës së specifikuar në paragrafin e mëparshëm nëse kjo kërkohet për të kryer detyrat me efektshmëri.

#### **Neni 6**

##### **Kompetencat e patrullave të përbashkëta**

1. Në kryerjen e detyrave si pjesë e patrullave të përbashkëta oficerët e Palës tjetër Kontraktuese kanë të drejtë të përcaktojnë identitetin e personave dhe të ndalojnë personat që tentuan t'i shpëtojnë kontrollit të Policisë, në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palës Kontraktuese në territorin shtetëror të të cilit kryhen detyrat.

2. Ushtrimi I të drejtave të tjera të policisë do të jetë nën kompetencat e oficerëve të Policisë të Palës Kontraktuese në territorin shtetëror të të cilit kryhen detyrat.
3. Në kryerjen e detyrave zyrtare zbatohet legjislacioni kombëtar i Palës Kontraktuese në territorin shtetëror të të cilit veprojnë oficerët e polic

## **Neni 8**

### **Të drejtat e patrullave të përbashkëta**

Gjatë patrullimeve të përbashkëta në territorin e Palës Kontraktuese, oficerët e policisë kanë të drejtë të:

- veshin një uniformë, të mbajnë një armë personale brezi, shkopinj gome, pranga dhe mjete të tjera shtrëngimi, përveç rasteve kur autoriteti i policisë i Palës tjetër Kontraktuese nuk e lejon këtë në një rast të veçantë ose nëse imponon kushte shtesë për përdorimin e këtyre mjeteve;
- të përdorë armën e shërbimit në rast mbrojtjeje të nevojshme;
- të hyjë në territorin shtetëror të Palës tjetër Kontraktuese pa vizë, pa një dokument udhëtimi dhe të qëndrojnë përgjatë kufirit të përbashkët shtetëror për aq kohë sa është e nevojshme për të kryer detyrat e patrullimit të përbashkët në një rast të veçantë;
- si rregull të kalojnë kufirin në një pikë pikat e kalimit kufitar ku të dyja palët kanë rënë dakort;
- si përjashtim të kalojnë kufirin shtetëror jashtë pikave të kalimit kufitar ose në pikat e kalimit kufitar jashtë orëve të punës nëse kjo është absolutisht e domosdoshme për kryerjen e patrullimit në territorin shtetëror të Palës tjetër Kontraktuese, në baze të njoftimeve paraprake;
- të përdorë pajisjet teknike të nevojshme për kryerjen e patrullimit të përbashkët në territorin shtetëror të Palës tjetër Kontraktuese.

## **Neni 9**

### **Bashkërendimi i punës së patrullave të përbashkëta**

1. Patrullimi i përbashkët bashkërendohet nga autoritetet rajonale përkatëse të Palëve Kontraktuese.
2. Autoritet në nivel qendror do të bashkërendojnë patrullimin e përbashkët në zonat e më shumë se një Njesi Rajonale Kufitare.

## **Neni 10.**

### **Mënyra e Punës**

1. Patrullimi I përbashkët mund të kryhet në këmbë ose me mjete transporti policore.
2. Patrullimi I përbashkët kryhet në mënyrë periodike në përputhje me veprimtarinë kriminale dhe kushtet klimaterike në zonën e përgjegjësisë.
3. Në rast nevoje dhe urgjence autoriteti që nënshkruan urdhërin e shërbimit sipas nenit 11 mund të vendosë që patrullat të përforcohen me forca dhe pajisje shtesë.

#### **Neni 11**

#### **Përbërja e patrullave të përbashkëta**

- (1) Mbushja e Personelit të Patrullave të Perbashketa do të varet nga supozimet taktike për secilin rast konkret, me kushte të parashikuara për të siguruar zbatimin e veprimit Policor.
- (2) Patrulla e Policisë normalisht përbehet nga dy oficerë policie vendas dhe një oficer policie mik.
- (3) Për të zgjedhur oficerë policie për Patrullat e Perbashketa është e nevojshme të merret parasysh njohja e gjuhës së palet tjetër Kontraktuese.
- 4 Vetëm oficerët e policisë të trajnuar sipas nenit 24 mund të marrin pjesë në patrulla të përbashkëta

#### **Neni 12**

#### **Dergimi në punë i patrullave të perbashketa**

Oficerët e Policisë, të cilët marrin pjesë në punën e patrullave të perbashketa në territorin Shtetëror të Palet tjetër Kontraktuese do të dërgohen në punë në përputhje me legjislacionin e tyre Kombëtar.

#### **Neni 13**

#### **Perzgjedhja e Patrullave të Perbashketa**

Patrullat e Perbashketa do të perzgjidhen nga Lista e Patrullës ose Rendi i Punës i Organit Kompetent të Policisë së Palet Kontraktuese në territorin Shtetëror të të cilit realizohet patrullimi. Një kopje e listës së patrullimit ose urdherit të punës do t'i dorëzohet oficerit të Policisë së Palet tjetër Kontraktuese.

- (1) Komandanti i Policisë mund të vendosi për devijimet (shkeljet) territoriale ose kohore të Listës së Patrullës ose Urdherit të Punës. Është

e nevojshme qe te regjistrohet situata reale ne Raportin e Punes se Patrulles se Perbashket.

#### **Neni 14**

##### **Urdhërimi i patrullave të përbashkëta**

(1) Patrullimet e përbashkëta urdhërohen me një urdhër shërbimi nga autoriteti kompetent I policisë së Palës Kontraktuese në territorin e shtetit në të cilin po kryhet patrullimi. Urdhëri I punës plotësohet në një formular tip I hartuar në gjuhën e Palës Kontraktuese në territorin e të cilës po kryhet patrullimi.

Një kopje e urdhërit i jepet Oficerit të policisë së Palës tjetër Kontraktuese.

(2) Çdo veprim I ndryshëm nga ato të parashikuar në urdhërin e punës bëhet në bazë të vendimit të drejtuesit të patrullës. Situata aktuale duhet të reflektohet në raportin e punës së patrullës së përbashkët.

#### **Neni 15**

##### **Instruktimi dhe Raportimi**

(1) Si rregull, instruktimi I patrullave të përbashkëta kryhet nga një përfaqësues i drejtuesit të stacionit të policisë në zonën në të cilën kryhet patrullimi I përbashkët.

(2) Drejtuesi I stacionit të policisë mund të vendosë një vend tjetër për instruktimin.

(3) Në përfundim të patrullimit raporti hartohet në gjuhën e Palës kontraktuese në territorin e të cilës po kryhet patrullimi dhe secila prej Palëve Kontraktuese pajisjet me nga një kopje të tij.

#### **Neni 16**

##### **Drejtimi i patrullave të përbashkëta**

Drejtuesi I një patrulle të përbashkët është një oficer policie I stacionit të policisë në zonën ku kryhet patrullimi I përbashkët I cili caktohet nga autoriteti I specifikuar në nenin 11 dhe është përgjegjës për përgatitjen profesionale dhe efikase, zbatimin e ligjit dhe raportimin.

#### **Neni 17**

##### **Mjetet e policies**

Patrullat pajisen me mjete për patrullimin e përbashkët nga stacioni I policisë në zonën në të cilën kryhet patrullimi.

### **Neni 18** **Mjetet e komunikimit**

Në patrullimin e përbashkët në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, oficerët e policisë mund të përdorin mjetet e tyre të shërbimit për të komunikuar me stacionin policor të origjinës. Në çdo rast, për të garantuar komunikim të vazhdueshëm oficerët e patrullës përdorin edhe mjetet e përfaqësuesve të Palës tjetër Kontraktuese.

### **Neni 19** **Uniforma, pajisje dhe armatim**

- (1) Gjatë patrullimit të përbashkët, oficerët veshin uniforma. Patrullimi kryhet në veshje civile nëse bihet dakort nga drejtuesit e stacioneve kompetente të policisë.
- (2) Përveç pajisjeve të specifikuara në këtë protokoll, patrullat e përbashkëta përdorin edhe pajisje të tjera që janë në përdorim të policisë kufitare, përveç kur një gjë e tillë bie në kundërshtim me legjislacionin kombëtar të Palës Kontraktuese në territorin e shtetit ku po kryhet patrullimi I përbashkët.

### **Neni 20** **Veprimi**

- (1) Oficerët e policisë së patrullave të përbashkëta marrin masat e para urgjente policore, ndërsa veprimi I mëtejshëm kryhet nga stacioni I policisë që ka kompetencën territoriale në territorin në të cilin kryhet patrullimi I përbashkët.
- (2) Dorëzimi dhe marrja në dorëzim e personave, sendeve dhe provave kryhet nga njësitë policore që bashkëpunojnë në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të përfunduara dhe legjislacionit kombëtar.
- (3) Ankesat për procedurat e policisë gjatë patrullimit të përbashkët shqyrtohen nga pala kontraktuese në territorin shtetëror të të cilit është kryer patrullimi. Të gjithë pjesëmarrësit e një patrulle janë të detyruar të japin deklaratë në lidhje me procedurat e ankimimit. Palët kontaktuese informojnë njëra-tjetrën menjëherë për ankimet.

## **Neni 21**

### **Përgjegjësia penale**

Në kryerjen e detyrave për zbatimin e këtij protokollit oficerët e policisë anëtarë të patrullave të përbashkëta që veprojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese kanë statusin e oficerëve të policisë së kësaj Pale Kontraktuese për vepra penale të kryera prej ose kundër tyre.

## **Neni 22**

### **Përgjegjësia e tjera**

1. Në rast se gjatë kryerjes së detyrave si pjesë e patrullave të përbashkëta, oficerët e Palës Kontraktuese dërguese shkaktojnë një dëm në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, përgjegjëse për këtë është Pala Kontraktuese dërguese sipas legjislacionit të Palës Kontraktuese në të cilin po kryhet patrullimi I përbashkët.
2. Pala Kontraktuese në territorin e së cilës është shkaktuar dëmi I përmendur në paragrafin 1 do të vlerësojë këtë dëm në bazë të kushteve për dëmin e shkaktuar nga oficerët e saj.
3. Pala Kontraktuese oficerët e së cilës kanë shkaktuar një dëm ndaj një personi në territorin e Palës tjetër Kontraktuese I rimbursos kësaj të fundit shumat e plota që I janë paguar viktimës ose personit që vepron në emër të tij.

## **Neni 23**

### **Sëmundja ose dëmtimi**

Në rast sëmundjeje ose dëmtimi gjatë patrullimit të përbashkët oficeri I policisë çohet në institucionin më të afërt shëndetësor dhe njoftohet menjëherë stacioni policor përkatës I Palës tjetër Kontraktuese.

## **Neni 24**

### **Trajnimi**

- (1) Oficerët e policisë duhet të trajnohen profesionalisht për të punuar në patrullat e përbashkëta.
- (2) Programi I trajnimit përgatitet dhe koordinohet nga strukturat përkatëse në nivel qendror të Policive kufitare të Palëve Kontraktuese. Trajnimi kryhet nga strukturat kompetente të policisë.

## **Neni 25**

### **Analiza e veprimtarise se Patrullave te Perbashketa**

Si rregull vlerësimi do të kryhet:

- Nje here ne vit në nivel të autoriteteve Drejtuese në nivel qëndror dhe kurdoherë që është e nevojshme.
- Çdo tre muaj në nivel të strukturave kompetente rajonale;
- Çdo muaj në nivel bashkëpunimi të stacioneve të policisë;

## **Neni 25 Shpenzimet**

Secila prej Palëve Kontraktuese mbulon shpenzimet e bëra prej saj për zbatimin e dispozitave të këtij protokolli.

## **Neni 26 Hyrja ne fuqi, Kohezgjatja dhe Perfundimi**

- (1) Ky Protokoll hyn ne fuqi me marrjen e Notes Diplomatike sipas se ciles Palet Kontraktuese informojne njera tjetren se kane plotesuar kushtet e parashikuara nga legjislacioni i brendshem per hyrjen ne fuqi te ketij Protokolli. Ky Protokoll do te vihete ne zbatim qe nga dita e nenshkrimit.
- (2) Ky Protokoll perfundon ne periudhe te papercaktuar kohe. Secila Pale Kontraktuese mund te anulloje Memorandumin ne cdo moment me shkrim, me rruge diplomatike. Anullimi hyn ne fuqi 3 muaj pasi Pala tjetere te kete marre shenimin mbi anulimin.
- (3) Ky Memorandumpushon se qenuri i vlefshem njeherazi me Marreveshjen mbi Bashkepunimin Policor Nderkufitarne mes Republikes se Shqiperise dhe Republikes se Kosoves.
- (4) Nënshkruar më \_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_, në dy kopje origjinale secila në gjuhën shqipe, maqedone, serbe dhe angleze, ku të gjithë tekstet janë njëloj autentikë. Në rast mosmarrëveshesh në interpretimin e Memorandumit, teksti ne anglisht do të mbizotërojë.

**PËR MINISTRINË E BRENDSHME  
TË REPUBLIKËS SË KOSVËS**

**PËR MINISTRINË E  
PUNEVE TE BRENDSHME  
TE REPUBLIKES SE MAQEDONISE**